

## Fletëshpjegim për kursin e integritit

për të emigruar të rinj me të drejtë pjesëmarrjeje dhe me detyrim pjesëmarrjeje si dhe për të huaja dhe të huaj me detyrim pjesëmarrjeje, që jetojnë tanimë më gjatë në Gjermani.

Të dashur bashkëqytetare, të dashur bashkëqytetarë!

Sipas ligjit për qëndrim ju keni një të drejtë, të merrni pjesë një herë në kurs integrimi respektivisht ju u detyruat për këtë.

### **Cfarë është një kurs integrimi?**

Kursi i përgjithshëm i integritit përbëhet nga një kurs gjuhe me 600 orë mësimi si dhe një kurs orientimi me 100 orë mësimi. Kursi i gjuhës përbëhet nga pjesë kursit me përkatësisht 100 orë mësimi. 300 orët e para të mësimit quhen kursi bazë i gjuhës, ndërsa 300 orët e tjera të mësimit që vijnë pas kësaj kursi i thellimit të gjuhës.

Në kursin e gjuhës ju mësoni një fjalor, i cili ju nevojitet për të folur dhe shkruar në jetën e përditshme. Këtu bëjnë pjesë kontakte me autoritet, biseda me fqinjët dhe kolegët e punës, shkrimi i letrave si dhe plotësimi i formularëve.

Kursi i orientimit ju informon mbi jetën në Gjermani si dhe ju jep njohuri mbi rendin juridik, kulturën dhe historinë e vendit.

Ka edhe kurse speciale integrimi p.sh. për gra, prindër, të rinj si dhe për persona të cilët nuk dinë të shkruajnë dhe të lexojnë mirë. Këto kurse zgjatin 1.000 orë mësimi. Në qoftë se ju mësoni veçanërisht shpejt, atëherë ju mund të frekuentoni një kurs intensiv. Ky zgjat vetëm 430 orë mësimi.

Cili kurs është i drejtë për ju dhe me cilën pjesë të kursit duhet të filloni, përcaktohet nga mbartësi i kursit me anën e një testimi para fillimit të kursit.

### **Pjesëmarrja në testimin përfundimtar**

Testimi përfundimtar përbëhet nga testimi i gjuhës dhe testimi i kursit të orientimit. Në qoftë se ju në testimin e gjuhës vërtetoni njohuri të mjaftueshme të gjuhës gjermane dhe e kaloni testimin e kursit të orientimit, atëherë ju e keni përfunduar me sukses kursin e integritit dhe merrni "Certifikatën e kursit të integritit".

Në qoftë se ju nuk kishit sukses, atëherë ju merrni një vërtetim mbi rezultatin e arritur. Pjesëmarrja në testimin përfundimtar është pa pagesë.

### **Përparësitë nëpërmjet pjesëmarrjes në kursin e integritit**

Të huajat dhe të huajt, të cilët vijnë nga një shtet i cili nuk bën pjesë në Bashkimin Evropian, duhet të plotësojnë disa kushte paraprake në qoftë se ata duan të marrin një të drejtë të pakufizuar qëndrimi në Gjermani. Përveç të tjerash ata duhet të kenë njohuri të mjaftueshme të gjuhës gjermane, njohuri bazë të rendit juridik dhe shoqëror dhe të kushteve të jetesës në Gjermani. Me përfundimin me sukses të kursit të integritit ju i keni përmbushur këto kushte paraprake. Përveç kësaj ju mund të merrni atëherë më shpejt shtetësinë gjermane.

Njohuritë e gjermanishtes të fituara në kursin e integritimit lehtësojnë përveç kësaj jetën e përditshme në Gjermani dhe i rrisin shanset në tregun e punës.

### **Regjistrimi në kursin e integritimit**

Nëse ju keni të drejtën e pjesëmarrjes në një kurs integritimi ose jeni të detyruar për pjesëmarrje, atëherë ju do të njoftoheni me anë të një vërtetimi me shkrim (vërtetim për të drejtën) nga autoritetet për të huajt ose nga organi përkatës përgjegjës për të hollat e papunësisë II. Njëkohësisht ju merrni po ashtu një listë të mbartësve të kurseve, të cilët kryejnë kurse integritimi në afërsi të vendbanimit tuaj.

Ju lutemi regjistrohuni për një kurs integritimi tek një vend i përmendur ndaj jush dhe paraqitni atje vërtetimin për të drejtën. Derisa nuk ju përmend juve një vend i caktuar, njoftohuni sa më shpejt që të jetë e mundur tek një mbartës kursi që e zgjidhni vetë. Nëse në vërtetimin për të drejtën nën "E drejta për pjesëmarrjen respektivisht detyrimi për pjesëmarrjen është e vlefshme deri më..." është vendosur një datë, atëherë ju mund respektivisht duhet të regjistroheni deri në këtë moment tek një mbartës kursi ose tek vendi që ju është përmendur.

Për të siguruar një pjesëmarrje brenda një kohe të shkurtër në kurs, Enti Federal mund t'ju dërgojë në një mbartës të caktuar kursi.

Mbartësi i kursit duhet t'ju tregojë kohën e parashikuar të fillimit të një kursi. Kursi nuk duhet të fillojë më vonë se gjashtë javë pas regjistrimit tuaj. Në qoftë se në këtë kohë nuk realizohet asnjë kurs integritimi, mbartësi i kursit duhet t'ju informojë. Në rast të një ndërrimi të kursit, mbartësi i vjetër i kursit duhet t'ju kthejë juve vërtetimin për të drejtën.

Ju lutemi merrni parasysh, që e drejta juaj për pjesëmarrjen fshihet, nëse ju, nga shkaqe që bien nën përgjegjësinë tuaj, nuk filloni më së voni se një vit pas regjistrimit me kursin e integritimit ose nëse e ndërprisni pjesëmarrjen në kurs më gjatë se një vit.

### **Pjesëmarrja e rregullt në kurs**

Me qëllim që ju të arrini synimin e kursit të integritimit, ju duhet të merrni pjesë rregullisht në kurs. Kjo do të thotë që ju të ndiqni rregullisht mësimin dhe të merrni pjesë në testimin përfundimtar. Pjesëmarrja e rregullt në kurs është po ashtu me rëndësi për ju, nëse dëshironi të përsëritni më vonë orët e mësimin të kursit të gjuhës. Mbartësi i kurseve ju vërteton me shkrim pjesëmarrjen tuaj të rregullt, nëse ju e dëshironi këtë.

Ndërrimi i mbartësit të kursit është parimisht i lejuar vetëm pas përfundimit të një pjese të kursit. Ndërrimi është i mundshëm vetëm në rast të ekzistencës së rrethanave të veçanta, në veçanti në rast të një shpërnguljeje, një ndryshimi ndërmjet kurseve me kohë të pjesshme dhe të plotë, për mundësimin e përkujdesjes së fëmijëve ose për fillimin e një mësimi profesioni ose veprimtarie pune pas përfundimit të një pjese të kursit.

### **Kostot e kursit të integritimit**

Ju duhet t'i paguani mbartësit të kursit 1,95 Euro për orë mësimi. Ky kontribut kostosh duhet të paguhet para fillimit të çdo pjese të kursit prej 100 orësh mësimore dhe para kursit të orientimit. Në qoftë se mungoni në mësim, shuma për orët e humbura të mësimin nuk mund t'ju kthehet mbrapsht. Në qoftë se ju nuk keni të ardhura vetjake financiare, atëherë shumë e kërkuar duhet ta paguajë personi, i cili është i detyruar të kujdeset për shpenzimet e jetesës suaj.

Enti Federal mund t'ju lirojë nga kontributi për kostot, në qoftë se ju e keni veçanërisht të vështirë pagimin për shkak të të ardhurave shumë të ulëta. Kërkesën për lirimin nga kontributi për kostot ju duhet ta bëni me shkrim tek Dega rajonale e Entit Federal, e cila është përgjegjëse për ju (shiko listën e adresave).

Ju lutemi bashkëngjitni vërtetimin mbi nevojat tuaja financiare (kopje të vërtetimit përkatës, p.sh. vërtetim të të hollave për papunësinë II, ndihmë sociale, ndihmë për banimin, nxitje financiare për formim profesional, shtesa për fëmijët, të holla sipas ligjet mbi pagesat për azilkërkesit, lirim nga pagesat e kopshtit ditor, përjashtim nga pagesat e Qendrës së tërheqjes së taksave, biletë sociale lokale, sigurimin e ndihmës për fëmijë dhe të rinj sipas Kodit Social VIII etj.). Ju lutemi, shtroheni kërkesën mundësisht përpara fillimit të pjesëmarrjes në kurs. Nëse ju e shtroni kërkesën gjatë kursit, lirimi nga kostot parimisht nuk mund të jepet me prapaveprim që nga fillimi i kursit.

Nëse ju merrni të holla për papunësinë II, dhe nga organi përkatës për këtë u detyruat për pjesëmarrjen në një kurs integrimi, ju jeni i liruar automatikisht nga kontributi për kostot. Në këtë rast ju nuk duhet të shtroni një kërkesë tek Dega rajonale e Entit Federal.

### **Përkujdesja për fëmijët**

Nëse ju, për të vizituar kursin e integrimin, keni nevojë për një përkujdesje për fëmijët, drejtoheni ju lutemi, tek mbartësi i kursit. Ky ju informon mbi mundësitë ekzistuese të përkujdesjes.

### **Rikthim i kontributit të kostove**

Nëse ju, pas datës 08.12.2007, keni marrë pjesë me sukses në testimin përfundimtar, Enti Federal mund t'ju paguajë mbrapa 50% të kontributit të paguar të kostove. Por kjo vlen vetëm, nëse ndërmjet lëshimit për herë të parë të të drejtës suaj për pjesëmarrje dhe testimit përfundimtar, nuk kanë kaluar më tepër se dy vjet. Për rikthimin ju duhet të shtroni një kërkesë tek Dega rajonale përgjegjëse e Entit Federal.

### **Shpenzimet e udhëtimit**

Nëse ju, në rast të tërheqjes së të hollave për papunësinë II, u detyruat nga organi përkatës për pjesëmarrje në kursin e integrimin ose u liruat nga Enti Federal nga pagesa e kontributit për kostot, ju mund të merrni një shtesë për shpenzimet tuaja të udhëtimit për në kursin e integrimin. Shtesa do të jepet në formën e një shume të përgjithshme për çdo ditë kursi. Kusht paraprak është megjithatë gjithmonë, që vendi i kursit të jetë të paktën 3 km larg nga banesa juaj. Për shtesën e kostove të udhëtimit ju duhet të shtroni një kërkesë tek Dega rajonale përgjegjëse e Entit Federal.

### **Përsëritje e kursit për thellimin e gjuhës**

Nëse ju nuk keni vërtetuar njohuri të mjaftueshme të gjuhës gjermane në testimin e gjuhës, atëherë ju keni mundësinë e përsëritjes edhe një herë të deri 300 orëve mësimore të kursit të gjuhës dhe të merrni pjesë përsëri pa kosto në testimin e gjuhës. Kusht paraprak për këtë është përveç kësaj, që ju të keni marrë pjesë rregullisht në mësim.

Pjesëmarrja në testimin e gjuhës nuk është e nevojshme, nëse ju ndiqni kursin e alfabetizimit.

Për pjesëmarrjen në orët e përsëritjes ju duhet të shtroni një kërkesë tek Dega rajonale përgjegjëse e Entit Federal.

### **Udhëzim për një detyrim për pjesëmarrje**

Në qoftë se ju u detyruat nga autoritetet për të huajt apo nga organi përgjegjës i të hollave për papunësinë II për të ndjekur një kurs integrimi, atëherë ju duhet të regjistrohni sa më shpejt që të jetë e mundur tek një mbartës i një kursi integrimi dhe të merrni pjesë rregullisht në këtë kurs.

Në qoftë se ju nuk e bëni këtë, atëherë kjo mund të ketë ndër të tjera për ju pasojat mëposhtme:

- Kjo mund të ndikojë në vendimin për zgjatjen e lejes së qëndrimit.
- Në qoftë se ju merrni ndihma sociale, këto ndihma mund të shkurtohen.

- 
- Eventualisht mund t'ju kërkohet nga autoritetet për të huajt, të paguani paraprakisht në një shumë kontributin e kostove në lartësinë prej 1,95 Euro për orë mësimi për të gjithë kursin e integritit.
  - Mund të caktohet dhënia e një gjobe.

Mbartësi juaj i kursit duhet të informojë autoritetet për të huajt ose organin përgjegjës për të hollat për papunësinë II, në qoftë se ju nuk merrni pjesë rregullisht në kursin e integritit.

### **Cfarë duhet të dini ju përveç kësaj**

Të gjithë formularët e përmendur në këtë fletëshpjegim mund t'i merrni nga mbartësi i kursit, tek autoritetet për të huajt ose tek Dega rajonale përgjegjëse e Entit Federal. Përveç kësaj ju i gjeni formularët në faqen e internetit [www.bamf.de](http://www.bamf.de).

Ky fletëshpjegim përmban informacionet më të rëndësishme për ju për pjesëmarrjen në kursin e integritit. Për detaje të tjera ju jep informacione mbartësi i kurseve.

Ju lutemi merrni parasysh përveç kësaj edhe ofertat e vendeve të këshillimit për migracion si dhe shërbimit për migracionin e të rinjve. Ato ju ndihmojnë gjatë shtrimit të kërkesave, ju përgjigjen pyetjeve dhe kujdesen për problemet tuaja dhe mund të kërkojnë për ju një kurs të përshtatshëm integriti. Ku ndodhen vendet e këshillimit për migracion si dhe të shërbimit për migracionin e të rinjve në afërsinë tuaj, ju e mësoni ose nga Dega rajonale përgjegjëse e Entit Federal, ose në internet nën [www.bamf.de](http://www.bamf.de).

Ju lutemi merrni parasysh se gjatë ndjekjes së kursit për integritim ju nuk jeni të siguar në sigurimin ligjor për aksidente.